

Classic sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

1

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

3

PASQYRA E PERFORMANCËS

4

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

5

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

6

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

7-20

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakët e Shoqërisë Classic shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Classic shpk** (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 2.5.3 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdijë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

8 korrik 2020



Luan Kamberi
Auditues Ligjor



Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	11,839,868	15,834,760
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	299,138,826	246,744,316
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	180,855,486	187,695,765
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	82,600,547	95,944,826
Inventarë	8	59,421,994	72,411,044
Shpenzime te shtyra	9	6,998,531	1,542,752
Totali i aktiveve afatshkurtra		640,855,252	620,173,463
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	10	496,685,447	444,395,531
Totali i aktiveve afatgjatë		496,685,447	444,395,531
Totali i aktiveve		1,137,540,699	1,064,568,994
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	248,921,356	398,095,857
Llogari të pagueshme tregtare	12	429,372,301	375,224,037
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	13	3,941,142	1,800,005
Detyrime tatimore	14	4,991,668	1,418,250
Parapagime dhe të ardhurat e shtyra	15	129,861,313	131,620,951
Të tjera detyrime	16	5,341,710	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		822,429,490	908,159,100
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë	17	279,490,975	126,516,978
Te tjera detyrime	18	10,228,681	7,405,201
Totali i detyrimeve afatgjatë		289,719,656	133,922,179
Totali i detyrimeve		1,112,149,146	1,042,081,279
Kapitali			
Kapitali themeltar	19	88,000,000	88,000,000
Rezerva statutore		166,500	166,500
Rezerva ligjore		13,500	13,500
Fitime të mbartura		(65,692,285)	(67,541,841)
Fitimi i ushtrimit		2,903,838	1,849,556
Totali i kapitalit		25,391,553	22,487,715
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,137,540,699	1,064,568,994

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	327,000,273	985,642,469
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	21	19,809,317	10,044,941
Total të ardhura		346,809,590	995,687,410
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(298,576,271)	(941,963,988)
Lënda e parë, materiale të			
1) konsumueshme dhe shpenzime të tjera	22	(288,691,157)	(919,676,855)
2) Të tjera shpenzime	23	(9,885,114)	(22,287,133)
Shpenzime të personelit	24	(31,504,002)	(36,332,188)
1) Paga dhe shpërblime		(27,231,300)	(31,847,300)
Shpenzime të sigurimeve			
2) shoqërore/shëndetësore		(4,272,702)	(4,484,888)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(12,829,374)	(15,301,975)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	-	(190,069)
Shpenzime financiare		(236,083)	2,369,256
Shpenzime interesi dhe shpenzime të			
1) ngjashme	26	(8,754,161)	(41,496,616)
2) Shpenzime të tjera financiare	27	8,518,078	43,865,872
Fitimi/humbja para tatimit		3,663,860	4,268,446
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	28	(760,022)	(2,418,890)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(760,022)	(2,418,890)
Fitimi/humbja e vitit		2,903,838	1,849,556
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		2,903,838	1,849,556

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Classic shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali themeltar	Rezerva Ligjore	Rezerva statutore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	88,000,000	13,500	166,500	(78,803,470)	11,261,629	20,638,159
Fitimi/Humbja e vitit					1,849,556	1,849,556
Transferimi në fitime/humbje të mbartura				11,261,629	(11,261,629)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	88,000,000	13,500	166,500	(67,541,841)	1,849,556	22,487,715
Fitimi/Humbja e vitit					2,903,838	2,903,838
Transferimi në fitime/humbje të mbartura				1,849,556	(1,849,556)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	88,000,000	13,500	166,500	(65,692,285)	2,903,838	25,391,553

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Classic shpk më _____ dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Artan Qesko
Administrator

Znj. Mimoza Palushi
Drejtuese e Financës

Classic shpk
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<i>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</i>		
Fitim / Humbja e vitit	2,903,838	1,849,556
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare	(284,705)	(13,302,799)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	12,829,374	15,301,975
Zhvierësimi i aktiveve afatgjata materiale		
<i>Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:</i>		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	(12,927,091)	(3,763,814)
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(37,665,730)	41,191,816
Rënie/(rritje) në inventarë	12,989,050	(1,152,556)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	63,444,891	16,410,559
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	41,289,627	56,534,737
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</i>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(79,646,057)	(21,238,526)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	27,453,857	16,860,379
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(52,192,200)	(4,378,147)
<i>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</i>		
Pagesa e huave	6,622,976	(51,172,062)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	6,622,976	(51,172,062)
<i>Ndryshimi neto i mjeteve monetare</i>	(4,279,597)	984,528
Mjetet monetare në fillim të periudhës	15,834,760	1,547,433
Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	284,705	13,302,799
Mjetet monetare në fund të periudhës	11,839,868	15,834,760

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "Classic" shpk është krijuar në korrik 1999, me vendim gjykate nr. 21604. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse në përputhje me ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Shoqëria ka NIPT J91909004J.

Shoqëria është një shoqëri shqiptare me ortakë:

- Z. Agron Papuli, zotëron 66.67% të kuotave të kapitalit të shoqërisë
- Z. Artan Qesko, zotëron 33.33% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 88,000,000 Lek, i ndarë në 100 kuota me vlerë 880,000 Lek secila. Administrator i shoqërisë është Z. Artan Qesko.

Selia e shoqërisë është në Autostradën Tiranë-Durrës, km 1, rruga dytësore, Godina Nr. 8, Kashar, Tiranë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie, si përfaqësues ekskluziv i firmës "Volkswagen A.G" është tregtimi dhe riparimi i automjeteve të grupit Volkswagen, organizimi i panairëve dhe ekspozitave për paraqitjen e automjeteve, dhënia e automjeteve me qira, etj.

Në 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka 32 punonjës. (2018: 34).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarjeje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%. Në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit, e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime mbi efektet pandemise në parimin e vijimesise

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme, inventari dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimesisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.6. Krahuesshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EUR/Lek	121.77	123.42
USD/ Lek	108.64	107.82

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar, sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme, duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime, të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e ç'montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlerë e mbetur	5%
Makineri e Pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Zyre	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje Kompjuterike	Vlerë e mbetur	25%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare) të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësies ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë, me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit, që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor, të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime, për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Mjete monetare në bankë dhe llogari të tjera	11,803,873	14,944,600
<i>Në lekë</i>	321,411	228,736
<i>Në monedhë të huaj</i>	2,793,942	2,209,244
<i>Garanci bankare</i>	8,688,520	12,506,620
Mjete monetare në arkë	35,995	890,160
	<u>11,839,868</u>	<u>15,834,760</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Klientë për shitje makinash	184,715,940	149,412,065
Klientë për shitje pjesësh këmbimi	58,685,039	50,731,069
Klientë Leasing Qira	55,255,699	46,259,609
Të tjera	482,148	341,573
	<u>299,138,826</u>	<u>246,744,316</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	127,757,706	134,228,603
Hua të dhëna palëve të lidhura	53,097,780	53,467,162
	<u>180,855,486</u>	<u>187,695,765</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Tatim fitimi i mbipaguar	2,324,064	1,228,352
Te tjera të arkëtueshme	80,276,483	94,696,474
Paradhenie per punonjesit	-	20,000
	82,600,547	95,944,826

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Makina	5,300,333	17,843,620
Pjesë këmbimi	54,121,661	54,567,424
	59,421,994	72,411,044

9. Parapagime dhe shpenzime të periudhave të ardhshme

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime te shtyra	6,998,531	1,542,752
	6,998,531	1,542,752

Classic shpk

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Mobilje e pajisje zyre	Pajisje informatike	Tëtjera	Totali
Kosto							
Gjendja më 31 dhjetor 2017	405,000,000	49,743,830	193,690,073	16,214,401	10,741,747	8,599,417	683,989,468
Shtesa		201,651	20,980,835		56,040		21,238,526
Nxjerrje jashë përdorimit			(47,768,084)				(47,768,084)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	405,000,000	49,945,481	166,902,824	16,214,401	10,797,787	8,599,417	657,459,910
Shtesa	30,000,000		49,606,349		39,708		79,646,057
Transferime							-
Nxjerrje jashë përdorimit		(292,500)	(45,709,117)				(46,001,617)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	435,000,000	49,652,981	170,800,056	16,214,401	10,837,495	8,599,417	691,104,350
Amortizimi i akumuluar							
Gjendja më 31 dhjetor 2017	28,486,250	44,624,238	129,934,206	14,148,914	9,466,869	5,773,446	232,433,923
Amortizimi i vitit		973,906	13,485,109	326,284	281,171	235,505	15,301,975
Nxjerrje jashë përdorimit			(34,671,519)				(34,671,519)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	28,486,250	45,598,144	108,747,796	14,475,198	9,748,040	6,008,951	213,064,379
Amortizimi i vitit		789,212	11,372,666	256,287	222,805	188,404	12,829,374
Nxjerrje jashë përdorimit		(281,351)	(31,193,499)				(31,474,850)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	28,486,250	46,106,005	88,926,963	14,731,485	9,970,845	6,197,355	194,418,903
Vlera neto kontabël							
Gjendja më 31 dhjetor 2018	376,513,750	4,347,337	58,155,028	1,739,203	1,049,747	2,590,466	444,395,531
Gjendja më 31 dhjetor 2019	406,513,750	3,546,976	81,873,093	1,482,916	866,650	2,402,062	496,685,447

Classic shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
(Vlerat janë në Lek)

11. Hua afatshkurtër

Huate afatshkurtëra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Huamarrje Afatshkurtra nga bankat	248,921,356	398,095,857
	248,921,356	398,095,857

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për blerje mallrash dhe shërbimesh	63,336,664	34,750,961
Parapagime nga furnitorët	366,035,637	340,473,076
	429,372,301	375,224,037

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	3,941,142	1,800,005
	3,941,142	1,800,005

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Sigurime shoqërore e shëndetësore	581,049	799,942
Tatim mbi të ardhurat personale te punonjësve	173,579	-
TVSH për t'u paguar	4,237,040	618,308
	4,991,668	1,418,250

15. Parapagime dhe të ardhurat e shtyra

Paradhënie të marra për eksportet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paradhënie të marra për eksportet	129,861,313	131,620,951
	129,861,313	131,620,951

16. Të tjera detyrime afateshkurtra

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga të pagueshme	1,593,625	-
Te pagueshme te tjera	3,748,085	-
	5,341,710	-

17. Hua afatgjata

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Huamarrje nga bankat	279,490,975	126,516,978
	279,490,975	126,516,978

18. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të tjera hua afatgjata të dhëna të tretëve	10,228,681	7,405,201
	10,228,681	7,405,201

19. Kapitali

Kapitali për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	Vlera	Nr i kuotave	Vlera	Nr i kuotave
Z. Agron Papuli	58,669,600	66.67	58,669,600	66.67
Z. Artan Qesko	29,330,400	33.33	29,330,400	33.33
Totali	88,000,000	100.00	88,000,000	100.00

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Nga shitja e makinave të eksportit	-	611,602,251
Nga shitja e makinave brenda vendit	202,991,619	234,739,168
Nga shitja e pjesëve të këmbimit	55,101,354	60,629,145
Nga makinat me qira e Leasing	50,593,657	57,655,724
Nga riparime dhe shërbime	18,313,643	21,016,181
	327,000,273	985,642,469

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	361,336,356
Shuma e qarkullimit të korrigjuar	361,336,356
Të ardhura të shfrytëzimit	346,809,590
Vlera kontabel e aktive afatgjata të shitura	14,526,766
	361,336,356

20. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratën e tatim fitimit:

Te ardhurat sipas deklarates se Tatim Fitimit	377,208,273
Te ardhura te shfrytezimit	346,809,590
Vlera kontabel e aktive afatgjata te shitura	14,526,766
Te ardhura nga interesat	15,784,885
Fitim nga kembimet valutore	87,032
	377,208,273

21 Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Rezultati nga shitja e AAM-ve*	12,927,091	3,763,814
Të tjera	6,882,226	6,281,127
	19,809,317	10,044,941
<i>Rezultati nga shitja e AAM-ve:</i>		
	27,453,857	16,860,379
Nga shitja e AAM-ve	(14,526,766)	(13,096,565)
Kosto e AAM-ve të shitura	12,927,091	3,763,814

22. Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime makina për eksport	-	590,134,769
Mallra makina	185,446,423	208,346,431
Mallra dhe pjesë këmbimi	52,011,609	56,992,146
Qira ambjenti dhe makina	36,609,194	39,206,803
Materiale dhe riparime të ndryshme	6,911,351	9,894,238
Karburant për makinat e shitura dhe gjenerator	1,817,500	1,856,807
Siguracione dhe shpenzime për targat e makinave	4,503,675	5,326,175
Shpenzime të shërbimeve doganore	214,866	671,025
Shpenzime transporti	782,197	6,323,364
Riparime, pjese makina garanci dhe brenda çmimit	260,964	156,656
Tarifa doganore	133,378	768,441
	288,691,157	919,676,855

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Taksa vendore	1,798,220	1,922,187
Shpenzime të ndryshme të pazbritshme	228,290	9,620,400
Konsulencë juridike e ekonomike	1,560,000	1,624,000
Kanclari e noterizime	742,129	808,276
Energji elektrike dhe ujë	1,431,060	1,577,283
Shpenzime telefoni e postare	1,979,774	1,553,913
Udhëtime e dieta	256,383	619,721
Te tjera	1,306,454	1,474,193
Sherbime bankare	61,576	1,904,978
Materiale pastrimi	357,808	319,939
Reklama	163,420	862,243
	9,885,114	22,287,133

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	27,231,300	31,847,300
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	4,272,702	4,484,888
	31,504,002	36,332,188

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoha dhe penaltete	-	190,069
	-	190,069

26. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat	87,032	99,817
Shpenzime interesi	(8,744,613)	(36,121,887)
Komisione	(96,580)	(5,474,546)
	(8,754,161)	(41,496,616)

27. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzime të tjera financiare detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga interesat	15,784,885	73,855,937
Shpenzime interesi	(7,266,807)	(29,990,065)
	8,518,078	43,865,872

28. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	3,663,860	4,268,446
Total shpenzime të panjohura	1,402,956	11,857,485
Penalitete gjoba dhe dëmshpërblime	-	190,069
Interesa të panjohura	653,063	1,662,978
Shpenzime të tjera	749,893	10,004,438
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	5,066,816	16,125,931
Humbje fiskale e mbartur		
Tatim fitimi @15%	760,022	2,418,890
	2,903,838	1,849,556

28. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Menaxhimi pret që zhvlerësimi i llogarive të arketueshme, inventari, dhe shtyrja e afatit të kontratave të ndertimit, të ndikohen nga situata. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 2.5.3 të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.